

**Raport: Monitorimi i votimit individual të projektligjeve në Kuvendin e Shqipërisë nga deputetët, në raport me premtimet elektorale të subjektit politik përkatës
Sesioni I, Legjislatura XVIII**

Fusha e veprimit: Lufta kundër korrupsionit e Reforma në drejtësi

Hyrje:

Qendra e Studimeve Parlamentare në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të Institutit Republikan Ndërkombëtar (IRI) ka zbatuar projektin me titull “Nevoja e ngritjes së një sistemi vlerësimi për deputetët”. Projekti ka si synim ngritjen e sistemit të vlerësimit të parlamentarëve duke monitoruar mënyrën e votimit individual të tyre në lidhje me premtimet elektorale të subjektit politik ku ata bëjnë pjesë.

QSP mendon se është me rëndësi për votuesit të kenë një informacion të plotë dhe të besueshëm i cili vlen t’i ndihmojë ata në të kuptuarin e performancës së deputetëve dhe forcës politike që ata përfaqësojnë dhe të Kuvendit në terësi. Është po aq e rëndësishme edhe për organizatat e shoqërisë civile të ruajnë autonomimë e tyre përballë këtij faktori të rëndësishëm të jetës politike në vend.

Në historinë e gjatë të shteteve, qënia e liderëve në pozicionet e tyre drejtuese përgjegjës para vendit dhe qytetarëve ka qënë një nga problemet më të mëdha të qeverisjes. Është e njohur botërisht që një qeverisje efektive dhe demokratike është e pamundur pa pasur transparencë dhe përgjegjshmëri: mungesë transparence do të thotë që pjesëmarrja e publikut është e vogël dhe një qeverisje më pak efektive; mungesë përgjegjshmërie do të thotë që ata që janë në pushtet mund të mohojnë lehtësisht vullnetin e popullit¹.

Qëllimi i projektit:

Projekti promovon transparencën në lidhje me aktivitetin e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë në seancat plenare, mbledhjet e komisioneve si dhe zyrat e deputeteve nëpërmjet advokimit mbi procedurat e njohjes së publikut mbi votimin individual të deputetëve në çdo legjislature. Çdo deputet duhet të kuptojë detyrimin për t’i raportuar zgjedhësve përmbushjet e premtimeve elektorale si dhe detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit.

Në funksion të asaj ç’ka u tha më lart QSP ka kryer një monitorim të punimeve të Kuvendit në seancë plenare gjatë gjithë sesionit të parë të tij, shtator-dhjetor 2009 të legjislaturës së XVIII. Më konkretisht QSP ka monitoruar legjislacionin e kaluar nga Kuvendi në lidhje me premtimet e bëra në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe reformës në drejtësi.

¹ Burimi: www.learningtogive.org

Metodologjia:

Metodologjia e monitorimit të kryer konsiston në monitorimin e punimeve të seancave plenare për dy fushat e paracaktuara. Monitorimi përfshin ndjekjen dhe analizën e diskutimeve të deputetëve për projektligjet e përfshira në seancë; pasqyrimin e numrit të deputetëve të pranishëm në seancë (kuorumi); ndjekjen e procesit të votimit të projektligjit, me elektronikë ose me kartona, të hapur ose të mbyllur; numrin e votave pro, kundër dhe abstenim.

Grupi i monitorimit ishte i përbërë nga 2 persona punonjës të Qendrës së Studimeve Parlamentare. Pjesëmarrja e tyre në seancat plenare u bë e mundur pas rinovimit të përjavshëm të fletëhyrjeve pranë kryesisë së Kuvendit. Seancat plenare gjatë sesionit të parë të Legjislaturës së XVIII të Kuvendit janë zhvilluar një ditë në javë, çdo të enjte (me përjashtim të muajit të parë të sesionit I ku seancat janë zhvilluar 2 herë në javë).

Grupi i monitorimit morri informacion edhe mbi dekretimin e projektligjeve të miratuara nga Presidenti i Republikës. Gjithashtu, monitorimi përfshiu edhe rastet e investimit të Gjykatës Kushtetuese për ato projektligje të cilësuar si antikushtetuese.

Premtimet elektorale:

Ajo që i ka paraprirë të gjithë procesit të monitorimit është një vëzhgim i hollësishëm i premtimeve elektorale të subjekteve politike bërë gjatë procesit elektorale të zgjedhjeve parlamentare 2009. Në vijim do të jenë premtimet elektorale të dy forcave politike që kanë marrë mandatin elektorale të krijimit të qeverisë pas zgjedhjeve të qershorit 2009, Partisë Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, respektivisht për dy fushat objekt monitorimi².

Partia Demokratike

Lufta kundër korrupsionit:

- Zvogëlojmë qeverinë dhe do të ulim edhe më tej shpenzimet;
- Do të ristrukturojmë sistemin e rregjistrimit të pasurive të patundshme dhe komisionet e kthimit e kompensimit të pronave për të garantuar të drejtën e pronës dhe për të luftuar korrupsionin;
- Do të shtrijmë në të gjitha nivelet dhe përmirësojmë procesin e tenderimeve online;
- Do të reformojmë të gjitha procedurat në të gjithë sektorët ku shfaqen ende fenomene korrupsioni.

Lëvizja Socialiste për Integrim

Lufta Kundër Korrupsionit:

- Lufta kundër korrupsionit do të drejtohet në ngushtimin e hapësirave ligjore për përdorimin e posteve publike për përfitime personale;

² Premtimet elektorale të partive politike, të shpallura gjatë fushatës elektorale dhe siguruar nga QSP në kuadër të një projekti tjetër të zbatuar nga Qendra, me titull: Monitorimi i zbatimit të detyrimeve ligjore për financimin e subjekteve zgjedhore në zgjedhjet parlamentare 2009

- Do të ndërtojmë një kulturë të re për rishikimin e shpenzimeve publike përmes publikimit të vlerësimeve periodike të programeve të veçanta publike;
- Do të mbështetet rritja e profesionalizmit e rolit investigativ të medias e shoqërisë civile;
- Do të nxitet pjesëmarrja aktive e publikut në monitorimin e masave kundër korrupsionit duke vendosur edhe tregues konkrete në luftën kundër tij.

Reforma në drejtësi:

- Rritjen e pavarësisë së sistemit, nëpërmjet kthimit në gjendjen e para 21 prillit të Kushtetutës përsa i përket institucionit të Presidentit si Kryetar i Këshillit të lartë të Drejtësisë, në Ligjin për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Ligjin për Shkollën e Magjistratures, Kodet Civile dhe Penale, si dhe Kodet Procedurale respektive;
- Ndryshimi i këtyre ligjeve duhet të sjellë ndarje të qartë të pushtetit ekzekutiv nga sistemi i drejtësisë, përmirësim të normave që rregullojnë menaxhimin e buxhetit të sistemit gjyqsor, zgjidhjen e konfliktit mbi statusin e inspektoriateve të KLD dhe Ministrisë së Drejtësisë, përmirësimin e rregullave për funksionimin e KLD;
- Reforma do t'i japë zgjidhje përfundimtare çështjes së statusit të Prokurorisë, marrëdhënieve të Prokurorisë me pushtetet e tjera, duke bërë reflektimet përkatëse ligjore e kushtetuese.

Në funksion edhe të monitorimit të kryer po përfshijmë edhe një përmbledhje të premtimeve të shprehura në programin e Qeverisë, program i shpallur ditën e votimit në Kuvend, në datë 16 shtator 2009, në fushat respektive të objektit të projektit.

Antikorrupsioni:

- Rritja e transparencës së vendimmarrjes dhe e llogaridhënies vertikale dhe tek publiku janë mjetet e tjera të rëndësishme që do të përdoren në parandalimin e korrupsionit.
- Reformë konsensuale për plotësimin e kuadrit ligjor dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të garantuar transparencë të financimeve të veprimtarive të partive politike dhe të fushatave zgjedhore.
- Kufizim i imunitetit dhe do të reduktohen privilegjet e zyrtarëve të lartë të të gjitha pushteteve. Prandaj dhe në kuadrin e zvogëlimit të shpenzimeve, abuzimeve, muajin e parë të këtij parlamenti, ne do të sjellim për miratim ligjin për heqjen e disa privilegjeve të pamërituara të administratës dhe institucioneve shtetërore.

Reforma në drejtësi:

- Përmirësimi i infrastrukturës e teknologjisë së informacionit mjeteve operative e mjediseve në dispozicion në sistemit e gjykatave e prokurorisë, rritja e pagave të gjyqtarëve e prokurorëve janë të domosdoshme dhe do të plotësohen me shpejtësi nga Qeveria.
- Forcimi i përmbartimit shtetëror dhe nxitja e shfrytëzimit të mundësive për shërbimin privat përmbartimor, nxitja e formave alternative të ndërmjetësimit dhe arbitrimin, përmirësime të përshtatshme të kodeve ligjeve materiale e procedurale civile, penale e administrative, përmirësime ligjore mbi rolin e avokatisë, noterisë, ekspertizave sektoriale, përmirësimit deri në standartet europiane të kushteve të

sistemit të vuajtjes së dënimit apo edhe përmirësimet në sistemin e arsimit të lartë juridik e masivizimi i edukimit ligjor të shoqërisë do të përbëjnë drejtime të tjera të rëndësishëm të reformave e masave me efekte pozitive të drejtpërdrejta dhe/ose dytësore në performancën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Rezultatet e monitorimit:

Raporti i monitorimit përfshin periudhën e sesionit të parë të Kuvendit të Shqipërisë, 7 shtator – 23 dhjetor 2009. Sesioni i parë ka filluar më 7 shtator 2009 dhe deri në mbarimin e tij, janë zhvilluar në total 17 seanca plenare dhe 47 orë diskutime parlamentare. Në këtë sesion u miratuan 70 ligje dhe 20 vendime. Në shumicën e rasteve ligjet e miratuara kanë kaluar me 73-74 vota, ku në total numri i deputetëve të pranishëm në këtë sesion është 75 deputetë pas mungesës së përfaqësuesve të opozitës.

Gjatë këtij sesioni kanë operuar të gjithë komisionet e përhershme parlamentare. Në 169 mbledhje, në më shumë se 210 orë, këto komisione shqyrtuan nismat ligjore, organizuan 40 seanca dëgjimore me më shumë se 47 grupe interesi, institucione publike apo jo publike dhe kanë ushtruar kontroll parlamentar³.

Çështjet më sensibil kanë qënë ato të integritetit të vendit, lëvizjes së lirë, përmbushjes së detyrimeve të vendit drejt anëtarësimit në BE.

Në terësinë e projektligjeve të miratuara në fushën e luftës kundër korrupsionit përmendim: paketën fiskale, ligji për transportin e nëpunësve të lartë, ligji i buxhetit të shtetit për vitin 2010, ligji për përgjimin e telekomunikacioneve. Kryefjala e miratimit të këtyre projektligjeve sikurse ka rezultuar edhe nga monitorimi i të gjithë diskutimeve të deputetëve në seancat plenare ka qënë thellimi i luftës kundër korrupsionit.

Ndërkohë në grupin e projektligjeve të miratuara për reformën në drejtësi, kjo ka rezultuar më e kufizuar, ku mund të përmendim vetëm ligjet ”antimafia”, ligji për bashkëpunëtorët e drejtësisë.

Gjatë këtij sesioni janë miratuar edhe një sërë marrëveshjesh, në objektin e monitorimit tonë kanë qënë marrëveshjet të tilla si ajo për sigurimin e kufijve dhe bashkëpunimin në luftën kundër krimit.

Në vijim do të ndalemi më hollësisht në ligjet e miratuara të fushës.

Në Anex 1 të këtij raporti paraqiten lista e të gjithë ligjeve të miratuara në Kuvend në këtë sesion.

Ligje të miratuara:

1- Në seancën plenare të 16 shtatorit 2009, Kuvendi miratoi përbërjen e kabinetit të ri qeveritar dhe programin politik të tij. Kabineti i ri qeveritar përbëhet nga 16 poste ministrore, ku posti i zv.kryeministrit është i shoqëruar edhe me atë të portofolit të

³ Burimi: fjala e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë në konferencën për shtyp datë 24.12.2009 pas mbarimit të sesionit të parë të kësaj legjislatore

ministrit të jashtëm. Në kabinetin e ri qeveritar është shtuar posti i ministrit të shtetit, portofol që nuk ka ekzistuar në kabinetin e mëparshëm. Numri i posteve ministrore vazhdon të mbetet i njëjtë, 16 por me një ndryshim në strukturë, duke u shtuar një portofol dhe njësuar ai i zv.kryeministrit me të ministrit të jashtëm. Pra, ndryshe nga sa është përmendur në premtimet elektorale të forcës më të madhe të koalicionit qeverisës, PD, nuk kemi një ulje të numrit të portofoleve ministrore.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i kabinetit të ri qeveritar dhe programit politik u bë i hapur, me kartona. Në përfundim u shënuan 73 vota pro, 1 kundër, 0 abstenim. Miratimi i kabinetit të ri qeveritar u bë pa debate në seancë.

2- Në seancën plenare të datës 28 shtator 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi paketën fiskale të përbëre nga 6 projektligje, përkatësisht: projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”; projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 ”Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”; projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”; projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; projektligji “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 10023, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar”.

Sikurse rezultoi edhe nga diskutimet që shoqëruan përcjelljen e paketës fiskale në Kuvend, grupi i projektligjeve siguron një reformim të të gjitha procedurave në të gjithë sektorët ku shfaqen ende fenomene korrupsioni, konform premtimeve elektorale të bëra nga forca kryesore politike, PD.

Kështu, paketa çon në: 1- lehtësimin financiar të personave apo të familjeve që janë të prag të legalizimit të ndërtesave; taksat e tabelës; (Prligj: Për sistemin e taksave vendore);

2- Përfundimi nga TVSH-ja i furnizimit nga importi të shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji; lehtësimin e barrës tatimore ndaj biznesit, në reduktimin e evazionit fiskal e të informalitetit, si dhe në saktësimin e unifikimit e legjislacionit (Prligj: “Për disa ndryshime në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”);

3- Lehtësi financiare për tatimpaguesit dhe rrit përgjegjësinë e administratës tatimore ndaj tyre (Projektligji “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”);

4- Rishikimin (rritja) e niveleve të tarifave fikse për kazinotë (Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për lojërat e fatit”);

5- Përafrimi i nivelit të akcizës për kategori të tilla si kafeja, pijet alkoolike dhe cigaret jo vetëm me nivelet e vendeve të rajonit, por edhe me ato të Bashkimit Europian me qëllim rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit (Projektligji “Për një ndryshim në ligjin “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”);

6- Ndryshime në taksat e akteve dhe të pullës, siç janë kthimi i disa tarifave në taksat, heqja e disa taksave dhe tarifave apo rivlerësimi i tyre; unifikimin e llojit dhe të nivelit të taksës për disa shërbime të gjendjes civile, thjeshtimin e procedurave dhe rritjen e cilësisë

së shërbimit administrativ, si dhe përmirësimin e kontrollit financiar ndaj tij. (Projektligji “Për një ndryshim në ligjin “Për taksat kombëtare”).

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 73 deputetë.

Votimi i paketës fiskale u bë me elektronikë. Në përfundim u shënuan 73 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i paketës fiskale u bë pa debate në seancë.

3- Në seancën plenare të 15 tetorit 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët e lartë dhe nëpunësit civilë”.

Projektligji synon një qeverisje me shpenzime të ulëta operative të administratës shtetërore dhe u konsiderua si pjesë e reformës për përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve publike. Ligji është i strukturuar në 5 kategori funksionarësh, duke vendosur se cila do të jetë masa e shpërblimit për secilin në trajtën e një bonusi financiar, i cili do të disponohet prej tyre për të përmbushur në çdo rast nevojat e shërbimit të transportit të tyre, në funksion të përmbushjes korrekte të detyrës funksionale. Projektligji preku funksionarë të tre pushteteve, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Ligji vjen si një masë në funksion të përmbushjes së premtimit elektoral për luftë kundër korrupsionit, në ngushtimin e hapësirave ligjore për përdorimin e posteve publike për përfitime personale/ulje të shpenzimeve publike; dhe si një kufizim i imunitetit dhe reduktimit të privilegjeve të zyrtarëve të lartë të të gjitha pushteteve.

Pas miratimit të tij në Kuvend, ligji u kundërshtua në Gjykatën Kushtetuese nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përkatësisht për pjesën që prek këtë grup funksionarësh të lartë në vend, “Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe gjyqtarët e gjykatës së apelit dhe të shkallë të parë”.

Gjykata Kushtetuese pasi morri në shqyrtim çështjen vendosi pranimin e ankimit të bërë nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, duke pohuar që ky ligj cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Gjykata rrëzoi këtë ligj si antikushtetues, edhe për faktin se të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve përcaktohen në Kushtetutë dhe mbi të nuk mund të dalin ligje që miratohen me shumicë të thjeshtë. Arsyetimi i përdorur nga togat e zeza ishte se zbatimi i ligjit të miratuar nga parlamenti mund të sillte pasoja të pariparueshme në punën e sistemit gjyqësor.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nën parim. Në përfundim u shënuan 74 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

4- Në seancën plenare të datës 22 tetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit për prokurimin publik, të ndryshuar”.

Ligji prek bazën ligjore dhe vendos rregulla të hollësishme për prokurimin e utiliteteve të tilla, si: blerjet masive të energjisë elektrike, ujit, shërbimit të transportit dhe shërbimit postar, për të cilat deri më sot, në mungesë të rregullave specifike, janë zbatuar rregullat e përgjithshme të prokurimit. Ai përbën një ndryshim të rëndësishëm, pasi për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të tilla shpenzohen çdo vit fonde të konsiderueshme nga buxheti qendror ose nga buxhetet lokale.

Ky projektligj vjen në funksion të premtimit të bërë për të reformuar bazën ligjore mbi të cilën zhvillohen tenderat dhe për një reformim të të gjitha procedurave në të gjithë sektorët ku shfaqen ende fenomene korrupsioni.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 71 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nën parim me kartona. Në përfundim u shënuan 71 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

5- Në seancën e datës 22 tetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.9157, datë 04.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikacioneve”.

Projektligji synon përforcimin e instrumenteve ligjore, për luftën ndaj evazionit fiskal, korrupsionit dhe ekonomisë informale në tërësi. Projektligji prek organizimin dhe funksionimin e organeve të drejtësisë, por edhe tatimore dhe doganore. Projektligji nga deputetët e mazhorancës u konsiderua në seancë si një ndër elementët kryesore dhe prioritare të reformës ekonomike.

Projektligji vjen në funksion të premtimit të bërë respektivisht nga të dyja forcat politike që kanë konstituuar qeverinë, PD dhe LSI, për një reformim të të gjitha procedurave në të gjithë sektorët ku shfaqen ende fenomene korrupsioni dhe për të nxitur një pjesëmarrje aktive në monitorimin e masave kundër korrupsionit.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 71 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nën parim. Në përfundim u shënuan 71 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

6- Në seancën e datës 22 tetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

Projektligji është pjesë e reformës së luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, korrupsionit dhe zbatimit të ligjit ashtu siç duhet; një ligj i ri me parime e kritere shumë më të specifikuar, në mënyrë që t’u japë sa më shumë hapësirë institucioneve shtetërore për kryerjen e detyrës.

Projektligji vjen në funksion të premtimit të bërë të parashikuar në programin e qeverisë për një reformë në masat me efekte pozitive të drejtpërdrejta dhe/ose dytësore në performancën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 71 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 71 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

7- Në seancën e datës 5 nëntor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror për zonat me përparësi turizmin”.

Ky projektligj synon të rregullojë një prej qëllimeve të administrimit të pronës shtetërore, atë të optimizimit të miradministrimit të saj si dhe kalimin te subjektet e interesuara të së drejtës së pronësisë mbi njësitë e ndërtuara në truallin brenda zonës së zhvillimit. Projektligji shihet si një masë efektive në ecurinë e reformës së pronës në Shqipëri dhe fondi i siguruar nga ky proces do të vihet në dispozicion të procesit të kompensimit financiar të pronarëve.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 73 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 73 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

8- Në seancat plenare të datave 19 e 26 nëntor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010”.

Projektligji për buxhetin e shtetit është ligji kryesor ekonomik dhe financiar në vend, rregullator bazë i të gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve për gjithë vitin 2010. Ky është një projektligj që angazhoi të gjithë deputetët e mazhorancës në seancë në diskutime të neneve të tij duke ofruar një përshkrim për buxhetin, të ardhurat dhe shpenzimet.

Projektligji u prezantua si zëri i çështjeve ekonomike dhe sociale të qeverisë, duke ecur në linjë me premtimet e bëra elektoratit për rritje pagash dhe pensionesh, ku prioritet kanë ato të ulëta, në masën 10%. Ligji i buxhetit ka parashikuar një rritje edhe të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, në të cilin parashikohet të bëhet edhe një reformë duke përjashtuar ata që përfitojnë padrejtësisht. Në buxhetin e vitit 2010, ministria e Punëve Publike, Transportit dhe telekomunikacionit, do të jetë ajo që do të thithë më shumë fonde nga buxheti i 2010-ës, përkatësisht 51.89 miliardë lekë. Ndërkohë, ministria e Integrimi do të jetë ajo që do të marrë më pak fonde. Gjithashtu në projektbuxhetin e 2010-ës është parashikuar që pagat të rriten nga 4-10 për qind, ndërsa pensionet nga 7 deri në 10 për qind. Sipas kryeministrit Berisha, realizimi i rritjes së pagave dhe pensioneve bëhet i mundur në sajë të uljes së shpenzimeve operative të administratës me rreth 30 për qind⁴.

⁴ Kryeministri Sali Berisha në fjalën e tij në Kuvend gjatë prezantimit të projektligjit të buxhetit 2010

Duke u përqëndruar në 2 fushat e monitorimit, është parë buxheti për dy dikasteret kryesore që merrem me hartimin dhe implementimin e masave për luftën ndaj korrupsionit dhe reformën në drejtësi.

Kështu: buxheti i Ministrisë së Brendshme për vitin 2010 është 17.565 miliard lekë. Në krahasim me buxhetin përfshirë ndryshimet të vitit 2009 prej 16.555 miliard lekë ka një rritje prej rreth 6%. Sipas drejtuesve të kësaj ministrie buxheti i vitit 2010 siguron mbështetjen e plotë financiare për realizimin e objektivave në drejtim të forcimit të rendit e sigurisë publike, luftës kundër kriminalitetit dhe trafikëve të paligjshme dhe në veçanti për mirëfunksionimin e sistemeve të instaluar në kuadër të plotësimit të kriterëve për liberalizimin e vizave me BE⁵.

Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010 është 6.85 miliardë lekë. Më konkretisht, në krahasim me vitin 2009 ka një rritje afërsisht 8 % ose 475 milion lekë.

Sipas drejtuesve të kësaj ministrie buxheti i vitit 2010 siguron mbështetjen e plotë financiare për realizimin e objektivave kryesisht në drejtim të investimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit, ku përmenden: Investimi në programin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor; Projekti i Informatizimit të Sistemit Penitenciar; Arkivi Elektronik i Sistemit të Drejtësisë; Përmirësimi i lidhjes on-line të sistemit gjyqësor me Ministrinë e Drejtësisë; Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes online të botimeve zyrtare; Aplikacioni i kartave EEB, për kartelat e të dënuarve, personelit dhe aktivitetit financiar të sistemit të burgjeve; sistemit të bllokuesve të valëve të telefonave celularëve; sistemit të kamerizimit të burgut të Korçës.

Investimet në Shërbimin e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si dhe Fondet me destinacion për kompensimin monetar të ish pronarëve shënojnë gjithashtu rritje për vitin 2010⁶.

Ndërkohë, vetëm pak ditë në parë, në 12.02.2010 në një konferencë për shtyp ministri i Financave, Ridvan Bode bëri të ditur rishikimin e ligjit të buxhetit 2010. Ai pohoi se do të rishikohet edhe një herë buxheti 2010 nga qeveria, duke minimizuar me 25 miliardë lekë shpenzimet e saj, ose rreth 5% të buxhetit. Ministri tha se ky ndryshim në buxhet do të prekë investimet që ishin parashikuar për vitin 2010, ndërkohë ka garantuar se nuk do të preken shpenzimet për pagat e pensionet. Ulja e shpenzimeve vjen si pasojë e krizës globale që ka infektuar ekonominë. Kjo është hera e parë që shteti shqiptar pranon zyrtarisht preken e vendit nga kriza ekonomike që ka mbërthyer botën.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 75 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nën parim. Në përfundim u shënuan 75 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Në momentin e votimit pati diskutime nga deputetët dhe u sollën disa ndryshime po që nuk preknin në thelb atë

⁵ Nga raporti i ministrit të brendshëm, Lulzim Basha në komisionin e ekonomisë në 23.11.2009

⁶ Nga raporti i ministrit të drejtësisë, Bujar Nishani në komisionin e ekonomisë në 23.11.2009

që ishte parashikuar në draftin e Qeverisë dhe miratuar nga mbledhjet e komisioneve parlamentare.

9- Në seancën e datës 3 dhjetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

I njohur si ligji “antimafia”, ky projektligj pati shumë jehonë jashtë Kuvendit, tek deputetët e opozitës dhe grupet e interesit si dhe aktorë të sistemit të drejtësisë.

Sikurse u vu re edhe nga monitorimi i seancës së diskutimit të këtij projektligji në seancë ai konsiston në përcaktimin e procedurave, kompetencave dhe kritereve për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në aktivitete të krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit.

Ky projektligj ka pikërisht këtë funksion parandalues dhe çmilitarizues: të dekurajojë zhvillimin e çdo aktiviteti mafioz në Shqipëri, sepse vetëdija se një ditë pasuritë e paligjshme do të sekuestrohen e demotivon krimin dhe, nga ana tjetër; të çaktivizojë burimet e mëdha financiare, që mbajnë në këmbë dhe gjallë organizatat kriminale. Përqasja parandaluese që sjell ligji i atribuohet degëve dhe agjencive qeveritare, i drejtohet prokurorisë, u drejtohet gjykatave, u drejtohet njerëzve të thjeshtë dhe bizneseve, për t'i bërë ata të përgjegjshëm për të reduktuar në maksimum mundësitë e lulëzimit të krimit të organizuar.

Ky projektligj u miratua vetëm me votat e mazhorancës parlamentare ndërkohë që pati një oponentë shumë të madhe nga radhët e opozitës jashtë parlamentit.

Partia Socialiste kundërshtoi miratimin e këtij projektligji pasi sipas saj në kushtet e ekonomisë informale, mjaft prona të shqiptarëve janë vënë pa kaluar në rrugët ligjore. Si të tilla ajo ka përmendur veçanërisht pronat e vëna nga emigrantët shqiptarë të cilët prej vitesh po sjellin para në Shqipëri në rrugë jo bankare. Opozita shprehet gjithashtu se në një situatë të tillë mund të sjelli edhe abuzime me zbatimin e këtij ligj.

Gjithashtu sipas PS, ky projektligj amendon ligje që kërkojnë tre të pestat e votave për miratim, pasi de facto amendon Kodin e Procedurës Penale apo ligjin për Gjykatën e Krimeve të Rënda.

Sipas PS, ky ligj i jep kompetenca të gjera policisë e prokurorisë pavarësisht nga përfshirja ose jo e personit në aktivitetet kriminale që parashikon ligji. Ky nocion i ri juridik, jo vetëm që nuk është i qartë, por edhe nuk përputhet me nocionin e ngjashëm që aplikojnë ato pak shtete që e përdorin atë.

Sipas PS miratimi me nxitim dhe pa u konsultuar i këtij ligji nga ana e mazhorancës ka gjasa të kthehet në një problem për respektimin e lirive dhe të drejtave themelore.

Projektligji vjen në funksion të premtimit të Qeverisë për reformë në drejtësi e marrje të masave me efekte pozitive të drejtpërdrejta dhe/ose dytësore në performancën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Ky projektligj përbën një nga kushtet e rëndësishme në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian për dobësimin e fuqisë ekonomike të organizatave kriminale dhe pengimin e infiltrimit kriminal të tyre në ekonominë e ligjshme. Ai është pjesë e paketës së rëndësishme të ligjeve kërkuar nga BE.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 74 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

10- Në seancën e datës 23 dhjetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Projektligji i ri vjen në kuadër të reformave që janë ndërmarrë në sistemin fiskal dhe është më shumë i lidhur me çështje organizative dhe strukturash, siç është krijimi i një drejtorie të re në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Kjo drejtori është quajtur Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion, ku funksioni kryesor i saj është parandalimi dhe hetimi i veprave korruptive të punonjësve të administratës tatimore. Projektligji trajton edhe mënyrën e dorëzimit të deklaratve tatimore duke shtuar atë elektronike. Dorëzimi në mënyrë elektronike i deklaratës tatimore passjell rritje të transparencës si dhe shmangie të evazionit fiskal.

Projektligji vjen në funksion të premtimit për luftë kundër korrupsionit në ngushtimin e hapësirave ligjore për përdorimin e posteve publike për përfitime personale si dhe reformim të të gjitha procedurave në të gjithë sektorët ku shfaqen ende fenomene korrupsion.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 74 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligji u bë pa debate në seancë.

Sikurse u theksua edhe në pjesën hyrëse të paraqitjes së rezultateve të monitorimit të punimeve në Kuvendit në sesionin e parë të tij, numri i projektligjeve që trajtojnë marrëveshje të Republikës së Shqipërisë me vende të tjera në fusha të ndryshme të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe është i madh. Ndër marrëveshjet me rëndësi për projektin tonë përmendim:

1- Në seancën plenare të datës 5 tetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

Marrëveshja i jep jetë bashkëpunimit në shkëmbimin e informacionit, në shkëmbimin e të dhënave dhe të përvojës, në bashkëpunimin sa i përket elementeve të rëndësishme kundër krimit, siç janë ato të konfiskimit të pasurisë së vënë nëpërmjet aktiviteteve kriminale, të mbrojtjes së dëshmitarëve, të luftës kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik me 2 vende.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 74 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligji u bë pa debate në seancë.

2- Në seancën plenare të datë 15 tetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligjin për “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

Marrëveshja i jep jetë bashkëpunimit në shkëmbimin e informacionit, në shkëmbimin e të dhënave dhe të përvojës, në bashkëpunimin sa i përket elementeve të rëndësishme kundër krimit, siç janë ato të konfiskimit të pasurisë së vënë nëpërmjet aktiviteteve kriminale, të mbrojtjes së dëshmitarëve, të luftës kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik me 2 vendeve.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 74 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

3- Në seancën e datës 3 dhjetor 2009, Kuvendi diskutoi dhe miratoi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar”.

Marrëveshje vjen në kuadër të përpjekjeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të luftuar krimin, sidomos që të sigurojnë qytetarët e tyre, por edhe të përmbushin atë pritshmëri të kërkuar nga BE-ja. Ato kanë lidhur një marrëveshje mes tyre për luftën kundër krimit. Duke qenë se krimi ka një natyrë ndërkombëtare dhe ndërkombëtare, edhe bashkëpunimi kundër tij duhet të jetë ndërkombëtar. Nevoja për bashkëpunim me institucionet e vendeve të ndryshme që zbatojnë ligjin ka lindur me kohë duke parashikuar gjithë veprat penale nga legjislacioni penal i Bosnjë-Hercegovinës dhe që janë shumë të ngjashme me ato që parashikon legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë.

Votimi:

Numri i deputetëve të pranishëm në seancë plenare është 74 deputetë.

Votimi i projektligjit u bë me sistem elektronik, fillimisht në parim dhe më pas nen për nen. Në përfundim u shënuan 74 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratimi i projektligjit u bë pa debate në seancë.

Përfundime:

Sikurse rezulton edhe nga monitorimi i bërë janë 10 projektligje dhe 3 marrëveshje të miratuara gjatë sesionit të parë të Legjislaturës së XVIII të Kuvendit të Shqipërisë që

prekin drejtpërdrejt të dyja fushat objekt monitorimi të projektit të zbatuar nga QSP, përkatësisht: lufta kundër korrupsionit dhe reforma në drejtësi.

Në të gjitha rastet e përmendura iniciativat ligjore i përkasin Këshillit të Ministrave. Pas diskutimit dhe miratimit të tyre në mbledhjet e komisioneve parlamentare, projektligjet kanë kaluar për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare. Sikurse u referua edhe nga materiali i paraqitur me lart, në të gjitha rastet projektligjet janë miratuar me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm në seancë dhe pa debate.

Ky raport paraqet vetëm një pasqyrë fizike/numër real të projektligjeve të miratuara nga Kuvendi, në funksion të qeverisjes së re të pas 29 qershorit 2009, dhe jo një analizë ligjore apo thelbësore mbi efektshmëri të efektshmërinë e masave të sanksionuara nga këto ligje të miratuara. Kjo edhe për shkak të mungesës së pjesës tjetër parlamentare në Kuvend, të opozitës socialiste, e cila në jo pak raste ka kundërshtuar nëpërmjet medias disa prej iniciativave ligjore të përmendura në këtë raport. Mospërfshirja e një analize thelbësore të përmbajtjes së ligjeve dhe neneve amenduese të tyre vjen edhe si rezultat i pamjaftueshmërisë së kohës (periudhës së monitorimit) për të parë efikasitetin e tyre dhe feedback i ardhur për këtë qëllim. Vlen të përmendet se të gjithë projektligjet e miratuara janë dekretuar nga Presidenti i Republikës dhe shumica e tyre kanë hyrë tashmë në fuqi pas botimit në fletoret zyrtare.

Gjithashtu, gjatë monitorimit është konstatuar edhe investimi i Gjykatës Kushtetuese ku është kundërshtuar miratimi i disa prej neneve të ligjit “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët e lartë dhe nëpunësit civilë”. Pas shqyrtimit Gjykata pranoi ankimin e bërë dhe rrëzoi nenet e këtij ligji lidhur me çështje që lidhen respektivisht me funksionarët e sistemit gjyqësor.

1- Lufta kundër korrupsionit:

Kështu, në përfundim të monitorimit 3 mujor të punimeve në Kuvendit të Shqipërisë, sesioni i parë, 7 shtator – 23 dhjetor 2009, janë miratuar 8 projektligje që kanë të bëjnë me fushën e luftës kundër korrupsionit. Këtu vlen të bëjnë një sqarim plotësues që paketa fiskale e miratuar nga Kuvendi ka në përbërje të saj 6 projektligje, pra, në total mund të llogarisim gjithsej 13 projektligje të miratuara gjatë këtij sesioni të kësaj legjislatore.

Nga vëzhgimi që i është bërë përmbajtjes dhe natyrës së këtyre projektligjeve arrijmë në konkluzionin që vetëm në një prej tyre nuk është mbajtur premtimi i bërë në kohën e fushatës elektorale nga forca kryesore politike, PD, për ulje të numrit të kabinetit qeveritar. Sikurse mund të shihet nga vendimi i miratimit të kabinetit qeveritar, datë 16 shtator 2009, nuk kemi ulje të numrit të posteve ministrore. Por, numri vazhdon të mbetet i njëjtë ndërkohë që vihet re një ndryshim në strukturë ku një person mban 2 poste ministrore, përmendim atë të zëvendësministrit me të ministrit të jashtëm dhe është shtuar posti i ministrit të shtetit.

Si konkluzion, mund të theksojmë se shumica e projektligjeve të miratuara në drejtimin e luftës kundër korrupsionit janë në zbatim dhe në mbajtje të premtimeve të dhëna në këtë

fushë gjithnjë në aspektin formal të iniciativës ligjore dhe amenduese, pasi nga ajo ç'ka pretendon ky raport nuk mund të konkludojmë për aspektin përbërës dhe thelbësor të tyre.

2- Reforma në drejtësi:

Nga monitorimi rezultojnë vetëm 2 nisma ligjore që kanë lidhje dhe mund të konsiderohen si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, përkatësisht projektligji për “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” dhe projektligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

Në fakt që prej daljes së Progres Raportit të Komisionit European, Ministria e Drejtësisë ka filluar punën për ristrukturimin e grupit të punës me qëllim rivlerësimin e Strategjisë për Reformën në Drejtësi⁷, e cila mendohet të kalojë në një proces të gjerë konsultimi për identifikimin e nevojave dhe prioriteteve. Mbase kjo mund të konsiderohet një prej arsyeve që gjatë sesionit të parë të kësaj legjislature shumë pak projektligje janë miratuar në këtë fushë, vetëm 2, por pa harruar edhe mungesën e numrit të deputetëve të opozitës, për të plotësuar kuorumin e kërkuar për miratimin e projektligjeve në këtë fushë.

Ndërkohë të depozituar në Kuvend dhe në pritje për miratim janë disa projektligje të rëndësishme si ai për krijimin e gjykatës administrative; për administratën gjyqësore; projektligji për Këshillin e Lartë të Drejtësisë; për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare apo projektligji për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

⁷ Raporti i prezantuar nga ministri i drejtësisë, Bujar Nishari, në komisionin e ligjeve në datë 09.11.2009.

Anex 1: Lista e të gjithë projektligjeve të miratuara në sesionin e parë të Kuvendit

Ligj nr. 10.211, datë 23.12.2009, Për miratimin e Aktit Normativ nr.9, datë 11.12.2009, “Për mënyrën e financimit të sistemit të Tachograph Digital në Shqipëri”.

Ligj nr. 10.210, datë 23.12.2009 “Për një shtesë në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002, “Për Akcizat”, të ndryshuar.

Ligj nr. 10.209, datë 23.12.2009 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.208, datë 23.12.2009 “Për një shtesë në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”.

Ligj nr. 10.207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, date 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.206, datë 23.12.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve”.

Ligj nr. 10.205, datë 23.12.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për ripranimin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm”.

Ligj nr. 10.204, datë 23.12.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripranimin e personave”.

Ligj nr. 10.203, datë 23.12.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve, dhe të protokollit të saj, për lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve gjatë qarkullimit në zonat kufitare”.

Ligj nr.10.202, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore”.

Ligj nr.10.201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”.

Ligj nr.10.200 datë 17.12.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit” të ndryshuar”.

Ligj nr.10.199, datë 17.12.2009 “Për ratifikimin e Protokollit 2 shtesë “Për përkufizimin e konceptit “Produkte origjinuese dhe metodat e bashkëpunimit ekonomik” që zëvendëson

protokollin me të njëjtin numër, të marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë”.

Ligj nr. 10.198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Ligj nr. 10.197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Ligj nr. 10.196, datë 10.12.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.195, datë 10.12.2009 “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Muriqan/Sukobinë”.

Ligj nr. 10.194, datë 10.12.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare”.

Ligj nr. 10.193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

Ligj nr. 10.192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ligj nr. 10.191, datë 03.12.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës Hercegovinës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit veçanërisht terrorizmit, trafikimet e paligjshme të drogave dhe krimit të organizuar”.

Ligj nr. 10.190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010”.

Ligj nr. 10. 189 datë 12.11.2009, “Për ratifikimin e protokollit për imunitetet dhe privilegjet e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi”.

Ligj nr. 10.188, datë 12.11.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes për thjeshtimin e procedurave të vizave për afaristët, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi”.

Ligj nr. 10.187, datë 12.11.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes për thjeshtimin e procedurave të vizave për shoferët profesionistë të kamionëve, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi”.

Ligj nr 10.186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror, në zonat me përparësi turizmin”.

Ligj nr 10.185, datë 5.11.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.184, datë 29.10.2009, “Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, të të vetëpunësuarve në bujqësi”.

Ligj nr. 10.183, datë 29.10.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Ligj nr. 10.182, datë 29.10.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Konferencës së Hagës "Për procedurën civile”

Ligj nr.10.181, datë 29.10.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2002”.

Ligj nr. 10.180, datë 29.10.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Ligjit për Patentat, të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (EİPO)”.

Ligj nr. 10.179, datë 29.10.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Patentave Evropiane”.

Ligj nr. 10.178, datë 29.10.2009, “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 8, datë 30.09.2009 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”.

Ligj nr. 10.177, datë 29.10.2009, “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 7, datë 30.09.2009 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10.130, datë 11.05.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”.

Ligj nr. 10.176, datë 29.10.2009, “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 30.09.2009 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000, “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.175, datë 29.10.2009, “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 30.09.2009 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.174, datë 29.10.2009, “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 4, datë 24.09.2009 “Për dërgimin e një toge mjekësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë në Kabul Afganistan”.

Ligj nr. 10.173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

Ligj nr. 10.172, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për përgjimin e telekomunikacioneve”.

Ligj nr. 10.171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.

Ligj nr. 10.170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.169, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.168, datë 22.10.2009 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sha-së”.

Ligj nr. 10.167, datë 22.10.2009 “Për heqjen e fondit pyjor kombëtar të sipërfaqeve të disa ngastrave të ekonomisë pyjore “Mali i Rencit, Lezhë dhe “Bushat - Bërdicë” Shkodër, që do të përdoren nga OTTO-AL shpk, karriera guri gëlqerorë e argjile”.

Ligj nr. 10.166, datë 15.10.2009, “Për një ndryshim në ligjin nr. 8306, datë 14.02.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.165, datë 15.10.2009, “Për përcaktimin e moshës së daljes në pension të punonjësve të nëntokës”.

Ligj nr. 10.164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

Ligj nr. 10.163, datë 15.10.2009, “Për miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “SEASIF GROUP” Sh.p.k.-së”.

Ligj nr. 10.162, datë 15.10.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çekisë, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

Ligj nr. 10.161, datë 15.10.2009, “Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2008”.

Ligj nr. 10.160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët e lartë dhe nëpunësit civilë”.

Ligj nr. 10.159, datë 15.10.2009, “Për shfuqizimin e ligjit nr. 8340/1 datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr. 204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave”.

Ligj nr. 10.158, datë 15.10.2009, “Për obligacionet e shoqërive aksionere dhe të qeverisë vendore”.

Ligj nr. 10.157, datë 15.10.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nrr. 9663, datë 18.12.2006 “Për konçensionet” të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.156, datë 15.10.2009, “Për miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “OTTO-AL” Shpk-së”.

Ligj nr. 10.155, datë 15.10.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

Ligj nr.10.154, datë 28.09.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10.025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”.

Ligj nr. 10.153, datë 28.09.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë, në programin ERDF, të bashkëpunimit territorial transnacional, “Hapësira e Evropës Juglindore”, të instrumentit të ndihmës së paraaderimit, IPA - komponenti i bashkëpunimit ndërkuftar, për vitin 2008”.

Ligj nr. 10.152, datë 28.09.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për programin e bashkëpunimit ndërkuftar, Adriatik, të instrumenteve të ndihmës së paraaderimit, IPA, komponenti II - bashkëpunimi ndërkuftar për Shqipërinë”.

Ligj nr. 10.151, datë 28.09.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për programin ndërkuftar Shqipëri - Mali i Zi, për vitin 2008, të komponentit të dytë të instrumentit të paraaderimit, IPA - bashkëpunimi ndërkuftar për Shqipërinë”.

Ligj nr. 10.150, datë 28.09.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së themelimit të Korporatës Islamike për sigurimin e investimeve dhe të kredive të eksportit”.

Ligj nr. 10.149, datë 28.09.2009 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.148, datë 28.09.2009 “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Ligj nr. 10.147, datë 28.09.2009 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.146, datë 28.09.2009 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.145, datë 28.09.2009 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.144, datë 28.09.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”.

Ligj nr. 10.043, datë 16.09.2009 “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 3, datë 10.08.2009 “Për dërgimin në Afganistan të një kompanie shtesë, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.